



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Dragas Municipality



KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 2 shkronja (d), neni 40 paragrafi 2 pika (j) të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", neni 6 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 nënparagrafi 2.1, neni 18 i Ligjit për Bashkëpunim Ndër komunal nr. 04/L-010 "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.07/2011, neni 6 i Rregullores për Procedurën e Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtar, neni 32.2 i Statutit të Komunës së Dragashit - 01 Nr.06-103/1 të datës 11.09.2008, Kuvendi i Komunës në Dragash në mbledhjen e mbajtur me datën 02.06.2025 pas shqyrtimit dhe votimit paraprak, miraton këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E NISMËS PËR BASHKËPUNIM KOMUNAL NDËRKOMBËTAR DHE FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR BINJAKËZIMIN NDËRMJET KOMUNËS SË DRAGASHIT DHE KOMUNËS SË MAVROVËS DHE ROSTUSHËS – MAQEDONIA E VERIUT

Neni I

Miratimi i nismës për bashkëpunim komunal ndërkombëtar

Miratohet nisma e Kryetarit të Komunës së Dragashit për fillimin e një procesi të bashkëpunimit komunal ndërkombëtar – binjakëzimit të komunave, si një hap i rëndësishëm drejt forcimit të marrëdhënieve me komunat e tjera jashtë vendit. Kjo nismë synon shkëmbimin e përvojave, zhvillimin e partneriteteve në fusha të ndryshme të interesit të përbashkët dhe avancimin e kapaciteteve institucionale të komunës përmes bashkëpunimeve me institucione të ngjashme ndërkombëtare.

Neni II

Komunat pjesëmarrëse në procesin e binjakëzimit

Procesi i binjakëzimit do të zhvillohet ndërmjet:

1. Komunës së Dragashit (Kosovë), dhe
2. Komunës së Mavrovës dhe Rostushës (Maqedonia e Veriut).

Qëllimi i këtij binjakëzimi është vendosja e një bashkëpunimi afatgjatë në fusha të përbashkëta si arsimi, kultura, zhvillimi ekonomik, turizmi, administrata publike, mbrojtja e mjedisit, menaxhimi i Parkut Nacional që përfshin të dy komunat, projektet ndërkufitare (IPA), si dhe përmirësimi i infrastrukturës rrugore që lidh komunat.

Neni III

Autorizimi për fillimin e procedurave të bashkëpunimit dhe përgatitjen e marrëveshjes

AUTORIZOHET Kryetari i Komunës së Dragashit të fillojë konsultimet zyrtare me autoritetet e Komunës së Mavrovës dhe Rostushës, me qëllim të përgatitjes dhe dakordimit të një marrëveshjeje të bashkëpunimit komunal ndërkombëtar.

Kjo marrëveshje, e cila do të përfshijë detaje për qëllimet e bashkëpunimit, fushat e interesit të ndërsjellë, format e bashkëpunimit, do të formalizojë procesin e binjakëzimit ndërmjet dy komunave dhe do të nënshkruhet pas përfundimit të të gjitha konsultimeve dhe procedurave ligjore të nevojshme.

Neni IV

Zbatimi i vendimit

Zbatimi i këtij vendimi do të bëhet nga Kryetari i Komunës së Dragashit në bashkëpunim me drejtoritë komunale përkatëse, varësisht nga fusha e bashkëpunimit që do të përfshihet në marrëveshje. Kryetari i Komunës do të ketë për detyrë të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme administrative dhe organizative për realizimin e këtij vendimi dhe për sigurimin e një procesi efikas dhe transparent të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Neni V

Hyrja në fuqi e Vendimit

Vendimi, hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8 dhe nenit 9 të Ligjit Nr.08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 24/2024'' dhe pas publikimit në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS - DRAGASH

01 Nr. 060/01-9710-2/25

Dt. 02.06.2025

Kryesuesja e Kuvendit
Arijeta Skeraj



A.Skeraj